



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

24 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Nga 5 mijë denarë për secilën bebe në Gjorçe Petrov




Shkup, 23 dhjetor – Këshilli i komunës së Gjorce Petrov në seancën e sotme ka marrë vendim për ndarjen e një ndihme financiare në vlerë prej 5 mijë denarë për secilën bebe që lind në këtë komunë. Vendimi hyn në fuqi gjatë vitit të ardhëshëm.

Ky qëndrim i këshillit meret për herë të parë nga një organ komunal. Ndërsa gjatë festave për 51 familje sociale do ndahet një ndihmë prej 3 mijë denarë, njofton Zhurnal.

Në këtë seancë sic bëjnë të ditur nga komuna, është marrë vendim për ndërtimin e pesë palestrave dhe atë në Hrom. DekSION. Gjorce Petrov. Noso Selo dhe Volkovo.

Humanistja maqedonase shëron të sëmurët nga kanceri pa pagesë





FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Shkup, 23 dhjetor- Pak persona bëjnë vepra të mira pa kontribut, ndërsa disa prej tyre shkojnë në konton e tridhjetë e një vjeçare Tatijana Stamenkovska e cila po punon në studion kozmetike "Tropik Beleca".

Ajo profesionalisht merret me metodën japoneze të mikroblading, ndërsa para disa kohësh zgjidhi pa pagesë problemet që kanë të bëjnë me gratë që shkojnë në hemoterapi.

Për shkak të veprës së saj, ajo dje mori mirënjohje nga akademja për mikroblading "Branko Babiq" ndaj të cilës shumë krenohej, transmeton zurnal.mk



Me vendim të Qeverisë, mbyllet Jugohromi



Qeveria e Republikës së Maqedonisë mbrëmë vonë ka marrë vendimin për të mbyllur Jugohromin dhe të pezullojë punën e kësaj fabrike për një afat të pacaktuar.

Çështja e Jugohromit ishte vendosur ditën e martë si pikë e rendit të ditës të mbledhjes së qeverisë, por u prolongua për të mërkurën. Kjo pike u vu në rend dite pas ndotjes enorme në Tetovë dhe pas protestave masive të qytetarëve, të cilët i drejtuan qeverisë ultimatum për të gjetur zgjidhje.



Bullgarët vijnë në Maqedoni për stomatolog dhe për karburant

Gjithnjë e më shumë bullgarë vijnë në Maqedoni për të përdorur shërbimet dentare pasi tek ata çmimet janë dy deri tre herë më të larta. Destinacioni më i afërt për këtë është në Dellçevë...



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Gazeta bullgare "Standard" shkruan se për urë, katër mbushje dhe nxjerrje të dhëmbit në Bullgari paguhet 1000 leva, ndërsa të gjitha këto në Dellçevë kushtojnë 400 leva. Distanca nga Blagoevgrad deri në Dellçevë është 38 kilometra kështu që, siç shkruan gazeta, ky ekskursion dentar duket i mirë madje edhe po të llogaritet karburanti për automjetin. Për shërbime dentare në Dellçevë paguhet në leva bullgare.

Bullgarët gjithashtu shkojnë në Maqedoni edhe për të blerë benzinë për shkak të dallimit të çmimeve të karburantit në të dy anët e kufirit. Kështu, sipas televizioni bullgar "Nova Televizija" një litër dizel në Bullgari kushton pak më shumë se dy leva, ndërsa në Maqedoni shitet për rreth 1.5 leva. (mia.mk)

Qeveria pezullon punën e "Jugohromit" për një kohë të pacaktuar



Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur mbrëmë, ka marr vendim që kombinati ndotës "Jugohrom" të pezullojë punën....

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur mbrëmë, ka marr vendim që kombinati ndotës "Jugohrom" të pezullojë punën për një kohë të pacaktuar, njofton Agjencia e Lajmeve "Zhurnal".

Sipas mediumit, vendimi është marrë me propozim të ministrave nga radhët e BDI-së, ndërkohë që arsyeja e vendimit është ndotja e ajrit në rajonin e Tetovës. Qeveria paralajmëroi për ditën e martë se do të mbante mbledhjen dhe do të shqyrtonte këtë çështje, por u prolongua për të mërkurën, dhe mbrëmë në orët e vona mori vendimin që gjiganti i dikurshëm tetovar të pezullojë aktivitetin prodhues.

Kërkesa për mbylljen e fabrikës së Jugohromit deri në vendosjen e filtrave, fillimisht kaloi në komisionin ekonomik të Qeverisë.

Për shkak të ndotjes së ajrit, nxënësit e shkollave të qytetit të Tetovës nuk do të mbajnë mësim deri në fund të simestrit të parë, ndërkaq ende nuk ka ndonjë njoftim zyrtar se kur do të kompensohen ditët e humbura të mësimt.

Në protestën e mbajtur para pak ditësh në Tetovë, të organizuar nga "Eco Guerilla", Qeverisë nga ana e organizatorëve i është dhënë ultimatum që deri të premtën ta zgjidhet çështja e "Jugohromit", si një ndër ndotësit më të mëdhenj në Tetovë, si dhe një sërë kërkesash të tjera. (mia.mk)



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Për fëmijët pa prindër, asistencë sociale



Dibranët janë humanist të dalluar. Ata nuk kursehen, sidomos ku shohin raste të rënda sociale, por edhe për shkollimin e fëmijëve që rrjedhin nga familjet sociale, por edhe ndihmojnë sidomos fëmijët jetim. Ky gjest human shpesh herë ka dalë në pah te shumë dibranë, në veçanti mërgimtarë tanë që jetojnë në SHBA. Ata në shumë mënyra kanë ndihmuar familjet në nevojë, duke ju ndërtuar shtëpi apo duke ju ndihmuar në forma të

ndryshme për shërim, shkollim apo ndonjë nevojë tjetër. Këto ditë në Dibër regjistrohet edhe një aktivitet humanitar që ka për qëllim t'u ndihmojë fëmijëve të cilët janë pa ndonjërin nga prindërit apo pa të dytë. Shoqata "Drita" po realizon një projekt për regjistrimin e fëmijëve jetim në Komunën e Dibrës. Sipas menaxherit të projektit, Erduan Klloboçishta, bëhet fjalë për fëmijë nga mosha 0-15 vjet të cilët nuk kanë ndonjërin nga prindërit apo të dy prindërit. Ai shton se në komunë ka një numër të theksuar të këtyre fëmijëve dhe qëllimi i shoqatës është që për këta fëmijë çdo muaj t'u paguhet asistencë sociale. Sipas Klloboçishtës, kjo ndihmë materiale do të jetë për disa vite me radhë dhe ky gjest human është shumë i mirëseardhur për këtë grup të fëmijëve, të cilët në të shumtën e rasteve ballafaqohen me problemet sociale. Duhet theksuar, shton Klloboçishta, se projekti është për të gjithë fëmijët pa prindër, pa marrë parasysh përkatësinë etnike apo fetare. Në shoqatë u informuam se edhe pse regjistrimi ka filluar këto ditë, ka shumë të interesuar dhe shpresojmë, thonë ata, se deri në fund të muajit të përfundojë regjistrimi, me çka nga janari të marrin ndihmë në të holla ata që i plotësojnë kushtet për këtë të drejtë. (V.S.)